



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

28-07-2023

01-110/05-991



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe neni 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën: 27.07.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i projekt planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023 do të jepet në diskutim publik deri më:30.08.2023. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së dëgjimit publik ne zyrën e sekretarisë së Kuvendit Komunal të Vitisë ndërtesa e komunës (ish tatimi në pronë), zyra nr. 2 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën fatlum.demiri@rks-gov.net, dokumenti gjendet në fep faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën 04.09.2023, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë. Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive në propozim planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.

Neni 5

Pas përfundimit të kohës për shqyrtim, komentim dhe finalizim të tij, propozimet i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim final.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Zyra e Sekretarisë së Kuvendit.

Neni 7